



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 356/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevc i anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi lidhur me ankesën e Sreten Ivanoviç – kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik GI Srpska Lista dega në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionerëve të vendotimit VV nr.0428D/01D dega në Gjilan, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 356/2017 e datës 14.06.2017, e parashtruar nga Sreten Ivanoviç – kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik GI Srpska Lista dega në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 14.06.2017 ka pranuar ankesën Anr. 356/2017 nga Sreten Ivanoviç – kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik GI Srpska Lista në të cilën pretendohet se në vendotimin VV nr. 0428D/01D në Kmetovë, komuna e Gjilanit, ka pasur pa rregullsi gjatë numërimit të votave, pasi që sipas vëshguesve unë kamë fituar 63 vota në këtë vendvotim, ndërsa në procesverbal në vend që të ceket numëri 63 figuron numëri 003 i votave të fituara. Parashtruesi i ankesës PZAP-it i ka kërkuar që të bëjë rinumërimin e votave nga vendvotimi i lartëcekur dhe të vërtetohet numëri i saktë i votave, në mënyrë që të përmirësohet gabimi i bërë sipas procesverbalit .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e

Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 356/2017 më datën 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.